



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 12.2 pika (c), nenit 17 shkronja (n) të Ligjit nr. 03/ L – 40 për vetëqeverisje lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës“, nr.28 / 2008) nenit 40 të Ligjit nr.2004/ 18 për tregtinë e brendshme, të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/03 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizimit të tregtisë, të dispozitave të nenit 31.2 pika (a) të Statutit të komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 30.12.2010 miratoi këtë:

**RREGULLORE  
PËR  
FILLIMIN DHE MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË BIZNESEVE NË  
KOMUNËN E VUSHTRRISË**

**1. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Qëllimi**

**Neni 1**

1.1 Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës së bizneseve në lëmin e tregtisë, hotelarisë, zejtarisë dhe shërbimeve tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2**

2.1 Organizatat biznesore në pajtim me nenin 1 të kësaj rregulloreje janë të obliguara t'i përmbahen orarit të punës, të përcaktuar me këtë rregullore.

**Neni 3**

3.1 Orari i fillimit dhe mbarimit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin kryhet veprimtaria. Duhet saktësuar orarin e punës para dhe pas dite si dhe ditët që nuk punohet.



## II Orari i punës

### Neni 4

Përcaktohet orari i punës në interval kohor :

Periudha verore fillon më 01.04. dhe zgjatë deri më 30.09 të vitit,

Periudha dimërore fillon më 01.10 dhe zgjatë deri më 31.03 të vitit

### Neni 5

5.1. Orari i punës për dyqane zejtare fillon dhe mbaron:

- a) Periudhës verore prej orës 07 : 00 – 20 : 00
- b) Periudhës dimërore prej orës 07:00 – 19 : 00

5.2 Gjellëtoret dhe qebaptoret do të punojnë çdo ditë pune:

- a) Në periudhën verore prej orës 06 : 00 – 23 : 00
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08 : 00 - 23 : 00

5.3. Ditën e vikendit ( e diel) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç: gjellëtoreve, qebaptoreve, salloneve të ondulimit, floktorjeve, autolarjeve dhe pikave për shitjen e shtypit ditor.

### Neni 6

6.1 Orari i punëve i supermarketeve, vetëshërbimeve, dhe dyqaneve ushqimore do të jetë :

- a) Në peridhën verore prej orës 07 : 00 – 23 : 00
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08 : 00 – 23 : 00


6.2. Orari i punës i dyqaneve tregtare të tekstilit, dyqaneve të këpucëve, teknikës së bardhë dhe veprimtarive të tjera jo ushqimore do të jetë:

- a) periudha verore, prej orës 08 : 00 – 21 : 00
- b) periudha dimërore, prej orës 08 : 00 – 20 : 00

6.3 Bizneset në pikë2 tëkëtij neni të dieleve nuk punojnë.

### Neni 7

7.1 Orari i punës i depove të artikujve ushqimor, depove të materialit ndërtimor dhe



bizneseve prodhuese do të jetë:

- a) Në periudhën verore prej orës 08 : 00 – 20 : 00
- b) Në periudhën dimërore prej orës 08 : 00 – 18 : 00

7.2 Ditën e vikendit e ( diel)dhe festive depot nuk punojnë.

7.3 Orari i punës për ndërmarrjet ndërtimore ( ndërtimi i ultë dhe i lartë) do të jetë:

- a) në periudhën verore prej orës 07 : 00 – 18 : 00
- b) në periudhën dimërore prej orës 08 : 00 – 17 : 00

### Neni 8

8.1 Orari i punës në kafene do të jetë:

- a) në periudhën e verore prej orës 07 : 00 - 24 : 00
- b) në periudhën dimërore prej orës 08 : 00 – 23 : 00

8.2. Orari i punës në hotele, motele dhe restorante është i njëjtë në të dy sezonet dhe fillon prej orës 07 : 00 - 24 : 00

8.3 Përjashtimisht nga pika 2 e këtij neni mund të punojnë më gjatë se orari i punës, por jo më shumë se ora 03 : 00 e mëngjesit. Lidhur me këtë duhet të kërkohet leja e veçantë të cilën e lëshon Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit - Sektori i Ekonomisë.

8.4 Për vazhdimin e orarit të punës duhet paguar taksën shtesë, 10 € për orë.

### Neni 9

9.1. Orari i punës për internet – kafe dhe bastore fillon në orën 8 : 00 dhe mbaron në orën 23 : 00

### Neni 10

10.1 Stadiumet e improvizuara të futbollit dhe palestrat punojnë pa kufizime.


### Neni 11

11.1 Veprimtaritë e parapara në nenet 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, gjatë orarit të punës nuk mund t’ua prishin qetësinë qytetarëve që banojnë në afërsi të tyre.

### Neni 12

12.1. Orari i punës për tregjet e qytetit dhe tregjet e lokaliteteve do të jetë:

- a) Në periudhën verore prej orës 06 : 00 – 19 : 00
- b) Në periudhën dimërore prej orës 07 : 00 – 18 : 00



12.2. Tregu i gjelbër është i hapur ditëve të punës, përveç të dielave dhe ditëve festive.

12.3. Tregu i kafshëve punon të premtëve.

### **Neni 13**

13.1 Në objektet hoteliere të cilat gjenden në afërsi prej 100 m nga objektet e banimit, e në të cilat organizohet program i gjallë muzikor apo me audio – video, mjete për reproduktimin e programit, programi nuk mund të mbahet pas orës 24 : 00.

### **Neni 14**

14.1 Orari i punës për pikat e shitjes së karburanteve, është i njëjtë për të dy sezonet dhe fillon prej 00 : 00 e zgjatë deri në ora 24 : 00 ( non stop).

### **Neni 15**

15.1 Orari i punës për barnatore, ordianca, laboratorë, rëntgen, shërbimet e ultrazërit dhe klinika private do të jetë i njëjtë për të dy sezonet dhe fillon prej orës 07 : 00 dhe mbaron në 22 : 00.

15.2 Barnaret që veprojnë në qytet në harmoni me planin për kujdestari të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Sektorin për Ekonomi në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim do të kujdestarojnë 24 : 00 orë non – stop.

### **Neni 16**

16.1 Organizatat biznesore mund ta zgjasin orarin e punës me rastin e festave të parapara me Ligjin për festat zyrtare deri në ora 01: 00.

16.2 Për të gjitha këto raste të parapara në pikën 1 të këtij neni nuk paguhet taksa shtesë.


## **III. DISPOZITAT NDËSHKUESE**

### **Neni 17**

17. Të gjitha organizatat biznesore do të gjobiten për kundërvajtje nga 200 – 400 euro në qoftë se veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregullore.

### **Neni 18**

18.1 Të gjitha organizatat biznesore të cilat marrin leje për orar të zgjatur të punës, nëse nuk e përfillin kodin afarist dhe rrezikojnë sigurinë e qytetarëve do t’u merret leja e punës e lëshuar nga Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit –Sektori i Ekonomisë.



## I. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PERFUNDIMTARE

### Neni 19

19.1 Për zbatimin e kësaj rregulloreje do të kujdeset, Sektori i inspektoratit të tregut, Policia e Kosovës, Gjykata për Kundërvajtje.

### Neni 20

20.1 Të gjitha organizatat biznesore, janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës, me dispozitat e kësaj rregulloreje, në afatin prej tridhjetë ( 30) ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

### Neni 21

21.1 Ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja 01. 796 të datës 28 -10 - 2004 për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës

### Neni 22

22.1 Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit dhe nënshkrimit nga ana e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.



KRYESUESI I KUVENDIT  
Ferit Idrizi

*Ferit Idrizi*

